

20
23



FAKULTETI I EDUKIMIT
UNIVERSITETI I
PRISHTINËS

DORACAK PËR TEZËN MASTER

Për studentët e programeve master në Fakultetin e
Edukimit

PËRMBAJTJA



03	HYRJE
04	PUNIMI I MASTERIT: STANDARDET DHE PROCESI
06	DISPOZITAT DHE PARIMET E PËRGJITHSHME
10	KRITERET E VLERËSIMIT TË TEZAVE MASTER
12	PËRSHKRIMI I NOTAVE/ STANDARDEVE
15	PROJEKT-PROPOZIMI I TEZËS SË MASTERIT
20	ETIKA HULUMTUESE DHE PLAGJIARIZMI
21	SHTOJCAT

HYRJE

FAKULTETI I EDUKIMIT
UNIVERSITETI I
PRISHTINËS

Punimi i diplomës master është aktivitet shkencor i studentit me të cilin duhet të dëshmohet se studenti gjatë kohës së studimeve ka fituar kompetenca sipas programit të studimit. Ky punim paraqet pjesën përfundimtare të studimeve Master sipas programit të planifikuar. Teza master, si fazë përfundimtare e studimeve në nivelin e dytë, u mundëson studentëve të tregojnë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për planifikimin, organizimin, realizimin dhe përfundimin e një projekti kërkimor. Punimi i masterit, është një projekt kërkimor shkencor, që duhet realizuar sipas rregullave akademike të kërkimeve shkencore, të përfshira në këtë doracak dhe në formatin përcjellës, "Modeli i shkrimit të tezave master" (në webfaqe tek rubrika 'Studentët', nën rubrika 'Studimet Master'), përmes të cilit përcaktohen standardet e realizimit dhe prezantimit të tezës së masterit. Teza e masterit dallon nga format e tjera të shkrimeve, për faktin se në këtë nivel problematikat, çështjet dhe situatat analizohen në kuptim më empirik, më të gjerë dhe më të thellë. Nëpërmjet realizimit të hulumtimit për temë masteri shpjegohet një dukuri apo çështje e caktuar dhe arrihen përgjithësime, të cilat mund të përdoren për të zgjeruar njohuritë dhe për të zgjidhur probleme të caktuara arsimore në kontekste më të përgjithshme. Projektet më të suksesshme janë ato, të cilat janë më detajuara dhe që trajtojnë një problem në mënyrë të strukturuar, sistematike dhe në thellësinë e duhur.

Planifikimi i tezës master dhe kohës së realizimit të secilës fazë duhet të bëhet me kujdes të veçantë dhe në bashkëpunim të ngushtë me mentorin/en (udhëheqësin/en). Shkrimi i punimit të masterit kërkon angazhim sistematik për të reflektuar në mënyrë analitike dhe kritike, për të përmbledhur dhe për të shprehur të menduarit në mënyrë të qartë. Ky doracak duhet të lexohet jo vetëm para se të fillohet me projektin kërkimor apo studimin, por duhet të konsultohet gjatë gjithë procesit. Kjo e lehtëson punën kërkimore dhe mundëson shfrytëzimin më efikas të kohës së konsultimeve me mentorin/en dhe realizuesin/en e projektit.

Doracaku ofron informata të hollësishme rreth përmbajtjes, standardeve dhe procesit të zhvillimit të projekt-propozimit për tezën master, si dhe hollësi për procesin hulumtues dhe procedurat që duhet të ndiqen deri tek mbrojtja e tezës së masterit, si kërkesë për diplomim. Në lidhje me realizimin e hulumtimit, gjithmonë është marrëveshja ndërmjet mentorit/es së punës dhe studentit/es ajo që përcakton rregullat specifike, që duhen ndjekur gjatë punës, por pa u shmangur nga kornizat e përgjithshme të këtij doracaku.

Ky doracak ka për qëllim mbështetjen dhe organizimin e efektshëm të procedurave të përgatitjes, mentorimit (udhëheqjes), mbrojtjes dhe vlerësimit të punimit të masterit në programet e Fakultetit të Edukimit. Megjithatë, doracaku nuk duhet të shërbejë si zëvendësim i literaturës për metodologjinë e hulumtimit, por duhet të përdoret krahas saj në mënyrë të vazhdueshme.

PUNIMI I MASTERIT: STANDARDET DHE PROCESI

Fakulteti i Edukimit tani ofron programe master me 120 ECTS, por në të kaluarën ka ofruar edhe programe me 60 dhe 90 ECTS. Rrjedhimisht, natyra e tezave përfundimtare për nivelin master do të dallojë sipas numrit të ECTS-ve, që i janë caktuar tezës së masterit, konform programit studimor. Përceptimi dhe realizimi i këtyre tezave do të dallojë në dy aspekte: në numër të fjalëve, si dhe në natyrën e studimit të bërë. Në programet master, ku teza ka 10 ECTS, lloji i hulumtimit duhet të ketë natyrë aplikative (10,000–12,000 fjalë), ndërsa të tjerat mundësojnë studime më të gjera dhe të thella të natyrës shkencore (12,000–15,000).

Studenti/ja mund të parashtrojë kërkesë për miratim të projekt propozimit për temën MA, pas përfundimit të të gjitha obligimeve të parapara dhe provimeve të semestrit të parë (për programet MA 60 dhe 90ECTS), respektivisht provimeve të vitit të parë (për programet MA 120ECTS). Forma e kërkesës për miratimin e projekt-propozimit të punimit të diplomës master merret në shërbim të studentëve ose në web faqe të fakultetit (formulari FIM). Studenti/ja, përkatësisht kandidati/ja për tezën master, në marrëveshje me mësimdhënësin/en (mentorin/en potencial/e), dorëzon projekt-propozimin (për hulumtim) tek Departamenti përkatës sipas udhëzimeve të specifikuara në rrjedhën e procesimit të temave Master (në webfaqe tek rubrika ‘Studentët’, nën rubrika ‘Studimet Master’). Pjesë integrale e projektit janë arsyetimi i temës së propozuar, qëllimi i studimit, përmbledhja e literaturës së shqyrtuar, pyetja/et e hulumtimit dhe hipoteza/t, metodologjia e hulumtimit, rezultatet e pritura, afatet kohore të realizimit të projektit dhe lista e referencave të literaturës së shqyrtuar. Kërkesa e kompletuar dhe e nënshkruar nga kandidati/ja dhe nga mentori/ja, me të cilin kandidati/ja është konsultuar, protokohet dhe dorëzohet te shërbimi përkatës i studentëve MA.


Punimi i masterit është punë e pavarur e studentit/es dhe puna realizohet në marrëveshje dhe nën mbikëqyrje të profesorit mentor. Kandidati/ja për punimin e masterit do të bëjë një hulumtim të pavarur për një problem të fushës së edukimit, e që ndër lidhet me fushën e studimit të programit që studenti/ja është duke e ndjekur. Gjatë zhvillimit të hulumtimit, kandidatët duhet të demonstrojnë se janë të aftë të bëjnë kërkim shkencor dhe të ndjekin të gjitha hapat në procesin e kërkimit, që shpie në punimin përfundimtar të tezës së masterit. Një kërkim i mirëfilltë gjithmonë fillon me shqyrtimin e literaturës, identifikimin e problemit të studimit dhe formulimin e qëllimit të hulumtimit (që pasohet nga pyetja/et e hulumtimit dhe hipoteza/t varësisht nga lloji i hulumtimit), definimin e metodologjisë së hulumtimit, përgatitjen për mbledhjen e të dhënave, realizimin e mbledhjes së të dhënave dhe analizën e interpretimin e tyre, nxjerrjen e të gjeturave, përfundimeve dhe rekomandimeve për të ardhur në fazën finale të shkrimit të temës së masterit, dhe prezentimit përfundimtar të saj.

PUNIMI I MASTERIT: STANDARDET DHE PROCESI

Në raste të veçanta, punimi mund të punohet edhe nga një grup kërkimor prej dy (2) apo tre (3) kandidatëve. Për punime të përbashkëta duhet të bëhet arsyetimi shtesë i argumentuar se volumi i punës dhe kontributi shkencor janë të barabartë me dy (2) apo tre (3) punime ose duhet të argumentohet që tema e propozuar më së miri realizohet nga dy (2) apo tre (3) hulumtues, shkak i thellësisë dhe gjerësisë së problematikës apo ndërdisiplinaritetit të temës së propozuar.

Punimi i masterit u mundëson kandidatëve para së gjithash:

- të thellojnë dhe zgjerojnë njohuri në një lëmi/fushë të veçantë;
- të demonstrojnë njohuri dhe të përfitojnë përvojë në procesin e hulumtimeve, duke filluar nga definimi i një problemi e deri tek hartimi i një raporti të hulumtimit (Teza e masterit);
- të tregojnë aftësi dhe kompetencë në planifikim të procesit dhe në mbledhje dhe analizim të të dhënave;
- të demonstrojnë shkathtësi të mirëfillta për të përpunuar në mënyrë kritike një temë të zgjedhur;
- të demonstrojnë shkathtësi të mirëfillta në organizimin e rezultateve të një hulumtimi në formë të shkruar dhe gojore;
- të demonstrojnë aftësi të shkrimit për qëllime akademike.



Tezat e shkruara në gjuhën shqipe, duhet të kenë të shkruar edhe përmbledhjen në gjuhën angleze, e nëse teza shkruhet në gjuhën angleze, përmbledhja duhet të jetë e shkruar edhe në gjuhën shqipe. Përveç këtij doracaku, studentët dhe mentorët duhet të shfrytëzojnë edhe udhëzuesin shtesë për hartimin e tezës së masterit, "Model i shkrimit të tezës master", dokument i cili është në harmoni me parimet kryesore të këtij doracaku. Të gjitha formularet dhe udhëzimet për procesin e temave janë publikuar në webfaqe tek rubrika 'Studentët', nënrubrika 'Studimet Master'.

DISPOZITAT DHE PARIMET E PËRGJITHSHME TË REALIZIMIT TË TEZËS MASTER

Teza si një kontribut origjinal i dijes – Teza, e shkruar në kuadër të programeve master, duhet të jetë një kontribut thelbësor dhe origjinal i dijes. Kandidati/ja sigurohet që teza e propozuar nuk është përsëritje e punës së bërë më herët (pra, është inovative), dhe është e mbështetur në literaturën relevante të viteve të fundit. Në kuadër të shqyrtimit të literaturës, studenti duhet të shqyrtojë edhe tezat paraprake master dhe ato të doktoratës në fushën e caktuar, për të mbindërtuar në punën e bërë më herët në kontekstin vendor, si dhe mbi literaturën relevante më gjerë.

Varësisht nga natyra e programit, inkurajohet që temat të integrojnë edhe fusha të përafërta studimi dhe të jenë ndërdisiplinare. Në rastet e temave të natyrës ndërdisiplinare, kjo reflektohet edhe në përbërje të komisionit.

Mentorimi - Kandidati/ja ka të drejtë të zgjedhë një mentor/e. Mentori/ja është përgjegjës/e të ndihmojë dhe udhëheqë punën e kandidatit/es. Mentori/ja e temës master duhet të ketë nivelin e kualifikimit profesor asistent e më lartë. Për të mentoruar një temë master profili i profesorit duhet të i përshtatet natyrës së temës së propozuar sa më shumë që është e mundur. Pasi mentori/ja ta pranojë propozimin e studentit për tezë të masterit, studenti/ja i kërkon Departamentit përkatës dhe pastaj Këshillit të Fakultetit miratimin e atij bashkëpunimi, me kërkesë të shkruar dhe të bazuar në një projekt-propozim. Forma e kërkesës për miratimin e projekt-propozimit të punimit të diplomës master gjendet në Shtojcën 1 (formulari FIM). Në raste të caktuara, kandidatit/es mund t'i caktohet edhe një bashkë-mentor me arsyetimin e mbështetjes së kandidatit/es dhe natyrën shumëdimensionale të temës përkatëse.

Departamenti përkatës, në afat prej 15 ditësh, shqyrton projekt propozimin e kandidatit/es për miratim dhe cakton anëtarët e komisionit konform rregullores aktuale për studimet master (Nr. 1/334, të datës 31.05.2023, neni 9 dhe 10) dhe standardit të mentorimit dhe formimit të komisioneve të tezave master në Fakultetin e Edukimit (në webfaqe tek rubrika 'Studentët', nënrubrika 'Studimet Master')

Konsultimet - Gjatë procesit të shkrimit të tezës master, kandidati/ja duhet të ketë konsultime të rregullta me mentorin/en. Nuk rekomandohet që kandidati/ja të punojë një kohë të gjatë në mënyrë të pavarur dhe pastaj ta konsultojë mentorin dhe t'i dorëzojë një tërësi të madhe të punimit, pa marrë paraprakisht sugjerime për secilin hap të realizimit të tezës master, duke përfshirë edhe çështjet si finalizimi i instrumenteve për mbledhjen e të dhënave, dhe shqyrtimin e literaturës- e që nganjëherë mund të perceptohen gabimisht si detaje të vogla, por në këndvështrim më të gjërë janë esenciale. Konsultimet janë po ashtu edhe obligim i mentorit/es, i/e cila duhet të jetë proaktiv/e në punën me studentë dhe sipas mundësisë (në rast se është duke mentoruar më shumë se një student) të organizojë takime, ku studentët do të shkëmbejnë përvojat e tyre gjatë realizimit të hulumtimit.



DISPOZITAT DHE PARIMET E PËRGJITHSHME TË REALIZIMIT TË TEZËS MASTER

Vlerësimi i tezës – Këshilli i fakultetit, në mbledhjen e radhës, por jo më vonë se 30 ditë pasi ka pranuar propozimin e Departamentit, shqyrton propozimin e departamentit për miratimin e projektpropozimit të punimit të diplomës master si dhe propozimin për emërimin e komisionit për vlerësimin e punimit të masterit dhe mbrojtjen e punimit të diplomës.

Mentori/ja është një nga tre anëtarët e komisionit. Konform rregullores aktuale për studimet master (Nr. 1/334, të datës 31.05.2023, neni 9) dhe standardit të mentorimit dhe formimit të komisioneve të tezave master në Fakultetin e Edukimit, dy nga tre anëtarët e komisionit të tezës së masterit duhet të jenë nga fusha e ngushtë e tezës master. Për anëtarin e tretë të komisionit duhet të vendoset nga parimi që studenti të ketë një komision sa më profesional dhe të synohet rritja e bashkëpunimit kolegial përtej departamenteve dhe duke avancuar qasjen ndërdisiplinare të studimeve në fakultet.

Mentori/ja është përgjegjës/e për të organizuar seancat apo format përmes të cilave komisioni dhe studentët shqyrtojnë progresin, bazuar në nevojat e identifikuara nga të gjitha palët. Komisioni duhet të miratojë përparimin e hulumtimit të kandidatit/es dhe planet e tij/saj në kohën kur kandidati/ja është gati për të filluar procesin e mbledhjes së të dhënave.

Vlerësimi – Kopja përfundimtare e tezës së masterit duhet të jetë e përgatitur mirë dhe e kompletuar, kur ajo i dorëzohet anëtarëve të komisionit për vlerësim nga shërbimi master. Kandidati nuk mund të paraqesë kërkesë për vlerësim të punimit master, pa i përfunduar të gjitha provimet e parapara me programin përkatës. Kërkesën për vlerësim formal, pas pëlqimit nga mentori, kandidati ia dërgon shërbimit master së bashku me një abstrakt të zgjeruar të punimit deri në tri (3) faqe.

Komisionit, përmes e-mailit zyrtar të shërbimit të studentëve MA, i dorëzohet kopja elektronike e dorëshkrimit. Pasi të pranojë kërkesën dhe kopjet e temës nga shërbimi i studentëve, komisioni, brenda 15 ditësh, e përgatit raportin e vlerësimit të dorëshkrimit të punimit master, sipas formularit F2M (Shtojca 2), i cili, i nënshkruar dhe i protokolluar, i dorëzohet shërbimit të studentëve të fakultetit përkatës. Nëse ka komente, atëherë kandidati duhet ta korrigjojë serish tezën.

Pasi komisioni paraqet raportin pozitiv për vlerësim të dorëshkrimit të punimit të diplomës master, përmes Departamentit mund të vazhdohet me procedurën e diskutimit publik dhe mbrojtjes së temës së diplomës master. Secili anëtar i komisionit është i obliguar të jetë pjesë aktive e përpilimit të raportit vlerësues duke dhënë vlerësim për dorëshkrimin bazuar në kriteret e përcaktuara më poshtë në këtë doracak. Në fund, mentori e përgatit raportin vlerësues dhe e dorëzon së bashku abstraktin e zgjeruar të punimit (deri në tri (3) faqe) në Departament, për miratim dhe shpallje të diskutimit publik.

Nëse ndonjë anëtar i komisionit nuk përgjigjet apo nuk kthen komente deri në kohën e specifikuar, atëherë me propozim të departamentit, Këshilli i Fakultetit e voton anëtarin e ri të propozuar nga rradhët e profesorëve. Në rastet kur ka mosmarrëveshje midis anëtarëve të komisionit rreth plotësimit të kriterëve minimale, Këshilli i Fakultetit do të emërojë një anëtar të katërt, i cili/e cila do të përgatisë një raport për Këshillin, para se të merret vendimi final. Për të vazhduar tutje në fazën e mbrojtjes, teza duhet të plotësojë së paku kriteret minimale të shtruara në këtë doracak (pjesa e kriterëve të vlerësimit më poshtë në këtë dokument).

Pas përfundimit të fazës së diskutimit publik dhe vlerësimit pozitiv të tezës nga komisioni për vlerësim, mund të procedohet me mbrojtjen publike. Hapat e detajuar të procesimit administrativ të temës MA, janë vendosur në webfaqen e Fakultetit.

DISPOZITAT DHE PARIMET E PËRGJITHSHME TË REALIZIMIT TË TEZËS MASTER

Diskutimi publik – Pas vlerësimit nga ana e komisionit, dhe miratimit në Departament, abstrakti i tezës do të publikohet dhe do të vendoset në diskutim publik për një periudhë 7 ditore.

I gjithë stafi akademik i Fakultetit të Edukimit mund të ketë qasje në draft tezën master në formë elektronike, dhe mund të ofrojë komente në formë elektronike apo të shtypur tek adresa zyrtare e shërbimit të studentëve MA brenda afatit të caktuar në rregulloren e studimeve Master.

Pas përfundimit të diskutimit publik, nëse nuk ka vërejtje dhe raporti është i nënshkruar nga tre anëtarët e komisionit, zyrtari përgjegjës administrativ i shërbimit master, përmes një konfirmimi me shkrim konstaton se janë përmbushur të gjitha kushtet për mbrojtje.

Mbrojtja – Kandidati/ja e mbron tezën e masterit në paraqitjen para një komisioni të emëruar nga Departamenti dhe miratuar nga Këshilli i Fakultetit. Mbrojtja e punimit të masterit është e hapur për publikun. Kandidatit/tes i jepet kohë prej afërisht 30 minutash për t'i paraqitur rezultatet e hulumtimit të tij/saj. Pas prezantimit, komisioni parashtron pyetjet që duhet të jenë të ndërlidhura drejtpërdrejt me punimin master.

Pyetjet mund të parashtrohen edhe prej pjesëmarrësve të tjerë (publikut). Kandidati/ja ka të drejtë të kërkojë pak kohë në mënyrë që t'i përgatisë përgjigjet (zakonisht deri në 30 minuta). Anëtarët e komisionit i dëgjojnë përgjigjet dhe ofrojnë komentet lidhur me to, ose kërkojnë shpjegime shtesë. Pastaj, komisioni tërhiqet për konsultim, për ta vlerësuar punimin e shkruar të kandidatit/es dhe mbrojtjen e paraqitur prej tij/saj. Në fund, kumtohet rezultati në mënyrë publike. Pas mbrojtjes, të gjitha tezat abstrakti i zgjeruar prej tri faqesh publikohet në web-faqen e Fakultetit të Edukimit.

Në raste të veçanta, me kërkesë të kandidatit/tes dhe miratim të shefit/shefes së departamentit, mund të organizohet mbrojtja edhe në formën online.



DISPOZITAT DHE PARIMET E PËRGJITHSHME TË REALIZIMIT TË TEZËS MASTER

Korniza kohore - Procesi i përfundimit të tezës master është si më poshtë:

- Teza master duhet të realizohet brenda 3-12 muajve nga dita kur Këshilli i Fakultetit miraton propozimin e projektit dhe përfshin kohën deri kur student/i/ja mbron publikisht tezën master;
- Studentët mund të paraqesin projekt-propozimin (e hulumtimit) pas përfundimit të provimeve të semestrit të parë (për programet MA 60 dhe 90ECTS), respektivisht provimeve të vitit të parë (për programet MA 120ECTS);
- Vlerësimi i dorëshkrimit të tezës master duhet të përfundohet nga komisioni i vlerësimit brenda 15 ditësh, pasi student/i të ketë dorëzuar zyrtarisht dorëshkrimin për vlerësim;
- Faza e diskutimit publik zgjat 7 ditë, pasi që komisioni të ketë dhënë vlerësimin pozitiv;
- Pas përfundimit të diskutimit publik, nëse nuk ka vërejtje dhe raporti është i nënshkruar nga tre anëtarët e komisionit, zyrtari përgjegjës administrativ i shërbimit master, përmes një konfirmimi me shkrim konstaton se janë përmbushur të gjitha kushtet për mbrojtje;
- Mbrojtja publike duhet të bëhet jo më parë se 5 ditë dhe jo më shumë se 30 ditë që nga konfirmimi nga shërbimi MA;
- Në rast se studentët nuk arrijnë të përfundojnë procesin e tezës brenda periudhës 12 mujore pas datës së miratimit të projekt propozimit, mund të aplikojnë për të marrë miratimin për një zgjatje prej edhe 12 muajsh nga ana e Këshillit të Fakultetit;
- Në rast se kandidati edhe pas afatit shtesë prej 12 muajsh, nuk arrin të përfundojë temën, konsiderohet se punimi nuk ka rezultuar i suksesshëm dhe kandidati obligohet të paraqes projekt të ri me mentor të ri;
- Fakulteti ka hartuar edhe infografikën e detajuar për procesin hap pas hapi që gjindet në webfaqe.

Formati - Shtypja e tezave të masterit duhet të bëhet në të dy anët e fletës A4. Punimi duhet të jetë i shkruar duke përdorur fontin Times New Roman, me madhësi 12. Hapësira mes rreshtash duhet të jetë 1.5 në të gjithë dokumentin. Detajet tjera të formatimit janë paraqitur në dokumentin "Modeli i shkrimit të tezës master".



KRITERET E VLERËSIMIT TË TEZAVE MASTER

Më poshtë janë paraqitur kriteret e vlerësimit për tezën master, që duhet të përdoren nga komisioni gjatë vlerësimit të tezës master, si dhe gjatë hartimit të raportit final të vlerësimit. Për më tej, këto duhet të përdoren edhe si pika referimi për studentët dhe mentorët gjatë procesit të zbatimit të projektit hulumtues.

Nota	KRITERI 1: Konceptimet teorike të fenomenit të studiuar; përdorimi i burimeve	KRITERI 2: Definimi i çështjes që hulumtohet dhe pyetjeve hulumtuese	KRITERI 3: Metodatat e mbledhjes së të dhënave dhe relevanca e të dhënave	KRITERI 4: Analiza e të dhënave	KRITERI 5: Prezantimi i rezultateve dhe përgjigjet ndaj pyetjeve hulumtuese	KRITERI 6: Interpretimi i rezultateve; diskutimi	KRITERI 7: Gjuha dhe koherenca strukturore
5	Pamjaftueshëm (dështon)	Pamjaftueshëm (dështon)	Pamjaftueshëm (dështon)	Pamjaftueshëm (dështon)	Pamjaftueshëm (dështon)	Pamjaftueshëm (dështon)	Pamjaftueshëm (dështon)
6	Një kornizë teorike e konceptualizuar dhe e zgjedhur dobët në raport me fokusin e hulumtimit. Përdorimi i dobët i burimeve, p.sh. burime të kufizuara, mungesa e kritikave të burimeve, përdorimi i burimeve të dorës së dytë	Ka gabime apo mungesë koherence në definimin e qëllimit të hulumtimit apo fokusimin e çështjes që studiohet. Lidhja me teorinë është e paqartë	Zgjedhja/përdorimi i metodave të mbledhjes së të dhënave është joadekuat apo jokonsistente. Të dhënat janë modeste, të fragmentuara apo dhe jopërfaqësuese në raport me qëllimin e hulumtimit	Mungon analiza sistematike; p.sh. vëzhgime të pëndërlidhura të të dhënave, apo analiza përmban gabime të dukshme dhe jo-koherencë metodologjike	Prezantim sipërfaqësor dhe përmbledhës. Prezantim i pamjaftueshëm. Përgjigje jo të plota në pyetjet hulumtuese	Të pamjaftueshme dhe në formë liste. Interpretimi i rezultateve ngelet në nivel vëzhgimesh dhe gjetjesh	Relativisht dobët dhe/apo e papërfunduar. Struktura është jo-logjike në disa pjesë, apo teza përmban gabime gjuhësore që e bëjnë të pamundur të kuptuarit e përmbajtjes
7	Qasja teorike është e lidhur jomjaftueshëm me fokusin e hulumtimit. Shfrytëzimi i koncepteve nuk është gjithmonë i qartë apo i lidhur me hulumtimin. Një numër i arsyeshëm i burimeve të shfrytëzuara, por shfrytëzimi i tyre jo edhe aq relevant	Qëllimi i hulumtimit është paraqitur dhe tema ndërlidhet me disiplinën. Por, pyetjet hulumtuese janë të zbehta apo jokoherente në raport me teorinë dhe të dhënat	Pyetjet hulumtuese mund të marrin përgjigje nga të dhënat, por ka mangësi në të dhëna apo në metodat cilësore dhe sasiore të mbledhjes së të dhënave	Të dhënat janë analizuar sipërfaqësisht, apo analiza ka mangësi metodologjike. Sidoqoftë, kontributi më qenësor i të dhënave është paraqitur	Rezultatet janë paraqitur në mënyrë formulative. Lidhja mes rezultateve dhe pyetjeve hulumtuese mbetet e thjeshtë	Mjaft e kufizuar, por mund të shihet lidhja mes interpretimit të rezultateve dhe pikënisjeve teorike e kërkimeve të mëhershme	Disa probleme apo gabime gjuhësore por strukturë relativisht e qartë

KRITERET E VLERËSIMIT TË TEZAVE MASTER

8	<p>Konceptet e zgjedhura dhe qasja teorike janë përshkruar në mënyrë të duhur, duke shpalosur njohuri të mjaftueshme të literaturës së vendit dhe ndërkombëtare. Burimet janë të mjaftueshme dhe të zgjedhura mirë</p>	<p>Qëllimi i hulumtimit është koherent në raport me teorinë dhe/apo të dhënat. Pyetjet hulumtuese janë definuar qartë dhe janë theksuar arsyet e rëndësisë së temës</p>	<p>Zgjedhja dhe përdorimi i metodave të mbledhjes së të dhënave është pothuajse e pagabueshme. Të dhënat janë të përshtatshme për t'iu përgjigjur pyetjeve hulumtuese, si dhe janë mjaft të gjera dhe të llojllojshme</p>	<p>Analiza është kryer në mënyrë të duhur dhe sistematike në raport me detyrën hulumtuese dhe natyrën e të dhënave, por pa eksplorim të thellë të dhënave</p>	<p>Rezultatet janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të strukturuar (p.sh. shembujt e të dhënave, tabelat, figurat). Rezultatet i përgjigjen pyetjeve hulumtuese</p>	<p>Dialog i cilësisë së mirë mes hulumtimeve të mëhershme, teorisë dhe të gjeturave; janë paraqitur edhe temat për hulumtimet e ardhshme</p>	<p>Sa i përket gjuhës, studimi është i një niveli të lartë. Struktura është koherente dhe e qartë. Gjuha pothuajse e pagabueshme</p>
9	<p>Prezantim dhe përdorimi i shkathtë i koncepteve dhe teorisë së zgjedhur. Përdorimi i burimeve vendore dhe ndërkombëtare tregon një njohje të mirë të fushës</p>	<p>Qëllimi dhe pyetjet hulumtuese janë paraqitur në mënyrë precize, të justifikuara dhe të lidhura shumë mirë me teorinë dhe të dhënat. Tema është e rëndësishme dhe arsyet për rëndësinë e saj janë paraqitur mirë</p>	<p>Zgjedhja e përdorimi i metodave është i pagabueshëm dhe kompetent. Të dhënat e hulumtimit janë të përshtatshme për qëllimin e hulumtimit dhe mundësojnë analiza të ndryshme</p>	<p>Analiza inferenciale të të dhënave sasiore që përcaktojnë parametra statistikor, testojnë hipoteza, krahasojnë modele të dhënash për marrëdhënie, ndërlidhje dhe parashikime. Të dhënat e natyrës cilësore janë paraqitur duke adresuar qartë elementin e besueshmërisë dhe vlerfshëmërisë dhe me një lidhje të avancuar me aspektet teorike dhe mundësi të nxirren interpretime e gjeneralizime teorike</p>	<p>Ilustrative dhe e pagabueshme. Rezultatet në mënyrë logjike i përgjigjen pyetjeve hulumtuese, dhe ndërlidhja me teorinë është e qartë</p>	<p>Diskutim sistematik, i gjerë dhe analitik i rezultateve, si dhe teorizim i lidhur me njohuritë e mëparshme. Sintetizimi i bazuar në rezultate për zbatueshmërinë e tyre</p>	<p>Pothuajse i pagabueshëm sa i përket përdorimit të gjuhës dhe terminologjisë. Struktura e tezës ka harmoni dhe rrjedhë të logjikshme</p>
10	<p>Është paraqitur një qasje koherente teorike në studim. Zotërimi i koncepteve është pa gabime dhe i kuptuar thellë. Përdorimi i burimeve tregon një njohje të thellë të fushës</p>	<p>Fokusi i hulumtimit ka rëndësi shkencore. Definimi i problemit është i një niveli të lartë dhe inovativ. Tema hulumtuese është më kërkuese dhe e rëndësishme se zakonisht, dhe tema e hulumtimit është sfiduese dhe mundëson kreativitet</p>	<p>Metodat e mbledhjes së të dhënave janë kërkuese, dhe përdorimi i tyre është përshtatur me shkathtësi për të përmbushur nevojat e hulumtimit, përfshirë edhe zhvillimin metodologjik. Të dhënat e mbledhura në mënyrë të kujdesshme mundësojnë konkludime dhe dëshmi të besueshme shkencore</p>	<p>Analiza inferenciale të avansuara (statistikore) që eksplorojnë marrëdhënie mes variablesh, marrëdhënie shkak-pasojë, ndikime, efekte, parashikime, analizë faktoriale dhe të ngjashme. Paraqitja e të dhënave cilësore është e pasur për nga mënyra e prezantimit, lidhja dhe kategorimi i të dhënave është bërë në një mënyrë të detajuar dhe me logjikë të fortë të ndërtimit të argumenteve në bazë të të dhënave dhe me mundësi për nxjerrje të interpretimeve dhe konkludimeve teorike</p>	<p>Rezultatet janë të paraqitura në mënyrë të shkëlqyeshme si në aspektin narrativ ashtu edhe grafik. Të gjeturat janë prioritarizuar në raport me pyetjet hulumtuese dhe teorinë, si dhe janë krahasuar me të gjeturat nga studimet e ngjashme në vende dhe/apo kohë tjera</p>	<p>Interpretimi i të gjeturave, përfshirë diskutimin e plotë, analizën dhe argumentimin ndërlidhet me teorinë dhe njohuritë e mëparshme. Konsideratë e thellë dhe kritike e studimit dhe etikës hulumtuese. Kontribute të pavarura kreative lidhur me zhvillimin metodologjik, analizën e zgjidhjeve apo konstrukteve teorike. Strukturë e qartë sa i përket shkrimit akademik. Stil koherent dhe gjuhë e nivelit të lartë</p>	

PËRSHKRIMI I NOTAVE/ STANDARDEVE

FAKULTETI I
EDUKIMIT

Përshkrimet më poshtë duhet të përdoren si pika referuese për notimin e përgjithshëm në format e vlerësimit të tezës master:

5 (pamjaftueshëm)- Studimi ka shkelur parimet themelore etike. Tema e studiuar nuk është relevante dhe sfondi teorik nuk është i lidhur me problemin që po studiohet. Studimi nuk përdor të dhëna të mjaftueshme për studimin dhe prezantimi i gjetjeve nuk lidhet me pyetjet kërkimore dhe problemin që po studiohet. Gjuha nuk është e pranueshme për shkrim akademik.

6 (mjaftueshëm)- Studimi i plotëson kërkesat minimale për tezë master në Edukim. Sfondi i studimit është ose shumë i ngushtë ose shumë i gjerë. Qëllimi i studimit është diskutuar, në një farë mase, në pjesën e hyrjes. Megjithatë, lidhjet me teorinë dhe kërkimet e mëparshme, si dhe me praktikën pedagogjike dhe arsimore nuk janë shpjeguar. Teoritë dhe studimet e përmbledhura janë të lidhura dobët me problemin e hulumtimit. Përdorimi i metodave të hulumtimit është i pamjaftueshëm ose jokonsistent. Prezantimi i rezultateve është sipërfaqësor apo në formë liste, dhe ka mangësi dhe mospërputhje në rezultate apo përfundime. Diskutimi është i mangët dhe nuk arrin një nivel më të përgjithshëm të interpretimit. Gjuha është mjaft e varfër.

7 (kënaqshëm)- Tema është e zakonshme, arsyetimet mbi të dhe fokusimi janë të pamjaftueshme. Teoritë përkatëse dhe rezultatet e hulumtimit janë prezantuar në formë të listës dhe në mënyrë mekanike, sfondi i paraqitur si tërësi është shumë i gjerë apo shumë i ngushtë. Autori është përpjekur të lidhë pikat fillestare të studimit, si dhe qëllimin dhe problemin e hulumtimit me njohuritë e mëparshme, por nuk ka pasur sukses. Disa nga elementet e qëllimit të hulumtimit janë dobët të lidhura me sfondin teorik, ose nuk merren parasysh në lidhje me rezultatet. Metodën e hulumtimit kanë mangësi, për shembull, trajtimin metodologjik. Rezultatet janë paraqitur në formë të njëtrajtshme (sipas një formule të njëjtë). Lidhja me kontekstin teorik mbetet modeste. Interpretimi i rezultateve tregon një lidhje të pikënisjes së studimit dhe me rezultatet e mëhershme.

PËRSHKRIMI I NOTAVE/ STANDARDEVE

FAKULTETI I
EDUKIMIT

Përshkrimet më poshtë duhet të përdoren si pika referuese për notimin e përgjithshëm në format e vlerësimit të tezës master:

8 (mirë)- Rëndësia e temës së zgjedhur është deklaruar dhe arsyetuar. Sfondi teorik i studimit është prezantuar në tërësi, dhe kjo tregon njohuri të mira për hulumtimet e mëparshme. Literatura e zgjedhur është relevante për problemet e hulumtimit dhe literatura e huaj është përdorur si një pjesë thelbësore e studimit. Sfondi teorik i tezës apo baza praktike e fenomenit është shtjelluar dhe lidhja me problemin hulumtues është demonstruar, edhe pse jo në detaje. Zgjedhja e metodës së hulumtimit është justifikuar në një mënyrë që tregon njohuri të metodave të hulumtimit. Metodatat e zgjedhura janë aplikuar në mënyrë konvencionale, kryesisht korrekte. Interpretimi i rezultateve është i një niveli të lartë, siç janë edhe përfundimet dhe ka pasur një përpjekje për të arritur një dialog midis teorisë dhe gjetjeve empirike. Diskutimi është i një niveli të lartë dhe ndërlidhet me përkufizimin e problemit dhe sfondin teorik. Është bërë vlerësimi i rezultateve të hulumtimit dhe janë identifikuar çështjet e reja për hulumtim të mëtejshëm, duke synuar zhvillimin e metodologjisë dhe/ose identifikimin e problemeve tjera, që lidhen me temën. Format i tezës është gati i përsosur dhe paraqitja e tezës është e një niveli të lartë. Teza tregon se mjeshtëria e autorit për elementet kryesore në procesin e hulumtimit është e avancuar. Në qoftë se tema përmban vetëm analiza deskriptive (përshkuese) dhe nuk ka analiza inferenciale të të dhënave, të ofruara në formën e duhur, atëherë nuk mund të vlerësohet me notë më të lartë se 8 (tetë).

9 (shumë mirë)- Teza trajton një temë inovative, relevante apo të rëndësishme, problemet e së cilës janë paraqitur dhe zhvilluar në mënyrë të pavarur. Sfondi teorik dhe pikat nismëtare të studimit demonstrojnë njohje të mirë të teorisë. Problemi i hulumtimit është përshkruar saktësisht, është arsyetuar mjaftueshëm dhe është bërë lidhje e mirë me sfondin teorik. Literatura vendore dhe ndërkombëtare është përdorur në mënyra të ndryshme. Është bërë punë e detajuar dhe kritike në përzgjedhjen e burimeve të literaturës, në raportim dhe dokumentim. Zgjedhja e metodës së hulumtimit dhe arsyetimet për këtë demonstrojnë njohuri metodologjike. Grumbullimi i të dhënave dhe metodat e analizave janë përdorur me shumë aftësi dhe vlefshmëria e tyre për qëllimin e hulumtimit është vlerësuar dhe demonstruar.

PËRSHKRIMI I NOTAVE/ STANDARDEVE

FAKULTETI I
EDUKIMIT

Përshkrimet më poshtë duhet të përdoren si pika referuese për notimin e përgjithshëm në format e vlerësimit të tezës master:

Metoda e zgjedhur për analizë është në harmoni me qëllimin dhe të dhënat e hulumtimit. Tema përmban analiza inferenciale, eksploron dhe interpreton ndërlidhje mes faktorësh dhe marrëdhënie shkak-pasojë. Të dhënat e natyrës cilësore janë paraqitur duke adresuar qartë elementin e besueshmërisë dhe vlerfshmërisë dhe me një lidhje të avancuar me aspektet teorike dhe mundësi të nxirren interpretime e gjeneralizime teorike. Interpretimi i rezultateve dhe konkludimeve është logjik, i justifikuar dhe i kontribuon hulumtimit si tërësi. Gjuha dhe struktura e tezës janë koherente dhe të një niveli të lartë.

10 (shkëlqyeshëm)- Tema e tezës tregon qartë se është më kërkuese apo më e rëndësishme se një tezë mesatare. Ajo vlerësohet si kontribut i rëndësishëm në njohuritë ekzistuese. Teza tregon familjaritet të thellë të autorit me teori të rëndësishme, probleme metodologjike dhe praktika shkencore, përveç zotërimit të shkëlqyer të punës hulumtuese dhe raportimit. Analizat statistikore janë të avansuara dhe eksplorojnë marrëdhënie mes variablesh, marrëdhënie shkak-pasojë, ndikime, efekte, parashikime, dhe të ngjashme. Paraqitja e të dhënave cilësore është e pasur për nga mënyra e prezantimit, lidhja dhe kategorimi i të dhënave është bërë në një mënyrë të detajuar dhe me logjikë të fortë të ndërtimit të argumenteve në bazë të të dhënave dhe me mundësi për nxjerrje të interpretimeve dhe konkludimeve teorike. Të menduarit e pavarur është i dukshëm në disa nënfusha të procesit të hulumtimit, veçanërisht në fushat e kriterëve të vlerësimit si më poshtë:

- ristrukturimi dhe sintetizimi i teorisë dhe hulumtimeve të mëparshme, në një mënyrë që prodhon perspektiva të reja;
- freski, rëndësi dhe inovacion të temës dhe qëllimit të hulumtimit;
- e fokusuar në qëllim, pikënisje dhe probleme të hulumtimit;
- zgjedhja, zhvillimi, vlerësimi dhe zbatimi i mbledhjes së të dhënave dhe/ose metodave të analizës;
- interpretimi i rezultateve, nxjerrja e përfundimeve dhe shtjellimi i diskutimit.

PËRMBAJTJA E PROJEKT-PROPOZIMIT TË TEZËS SË MASTERIT

Projekt-propozimi, për temën e masterit, duhet të miratohet në Këshillin e Fakultetit pas rekomandimit të Departamentit. Projekt-propozimi nuk duhet të kuptohet vetëm si një kërkesë zyrtare. Në fakt ai paraqet planin e hollësishëm kërkimor të studentit/es. Nëse plani është problematik në një apo më shumë segmente të tij, apo nuk është konceptuar qartë e mirë, atëherë kjo parqet një parakusht për realizimin e pasuksesshëm të një hulumtimi, apo cilësinë e ulët të hulumtimit për tezën e masterit. Një projekt-propozim i mirë reflekton qartë respektimin e kriterit të mbështetshmërisë, besueshmërisë, vlefshmërisë dhe transferueshmërisë së studimit të propozuar. Për këtë arsye, hartimi i projekt-propozimit duhet të merret si një detyrë shumë serioze nga kandidatët dhe mentorët, ndërsa kandidati/ja nuk duhet të fillojë studimin nëse ekziston ndonjë paqartësi, qoftë në perceptimin e saktë të problemit që studiohet, qoftë në qasjet metodologjike që duhet të ndiqen. Për këtë arsye, përgatitja e projekt-propozimit duhet të shihet si përgjegjësi e përbashkët e kandidatit/es dhe mentorit/es, ndërsa hartohet nga kandidati/ja si punë e pavarur dhe individuale.

Në përmbajtjen e një projekt-propozimi të tezës së masterit përfshihen:

Titulli i tezës

Abstrakti

Fjalët kyçe

Hyrja

Shqyrtimi i literaturës

Definimi i problemit, qëllimi i hulumtimit, pyetjet dhe hipotezat e hulumtimit

Metodologjia e hulumtimit

Instrumentet për mbledhjen e të dhënave

Rezultatet e pritura të hulumtimit

Afati kohor i realizimit të hulumtimit

Çështjet etike të hulumtimit

Referencat bibliografike

Projekt-propozimi i tezës së masterit nuk duhet të ketë më shumë se 10 faqe. Më poshtë janë elaboruar në hollësi të gjitha pjesët që përmban një projekt-propozim.

TITULLI I TEZËS

Titulli i tezës duhet të jetë i shkurtër dhe i qartë (rekomandim: në parim jo më i gjatë se 20 fjalë). Titulli duhet të përkojë me përmbajtjen e vërtetë të temës, qëllimin e hulumtimit. Duhet shmangur fjalë/shprehje të përgjithshme (abstrakte) dhe duhet bërë përpjekje të përpilohet një titull konkret dhe specifik, që i komunikon qartë lexuesit se për çfarë ka të bëjë hulumtimi. Një titull i mirë lidhet mirë me pyetjen e hulumtimit dhe fjalët kyçe.

ABSTRAKTI

Hulumtimi paraqitet përmes një abstrakti: përkufizimi i problemit, pse është i rëndësishëm studimi i tij (në raport me diskutimet bashkëkohore të fushës së studimit), cila është pyetja e hulumtimit dhe/ose hipoteza e përgjithshme, metodat, instrumentet, procedurat dhe rezultatet e pritura. Në parim, abstrakti nuk duhet t'i tejkalojë 350 fjalë.

FJALËT KYESORE (KYÇE)

Fjalët kyçe janë terma përshkruar për temën e hulumtimit. Në parim, duhet të jenë 3-5 fjalë që radhiten sipas renditjes alfabetike.

HYRJA

Në këtë pjesë prezantohet fusha e studimit, rëndësia e problemit të zgjedhur dhe elaborohen arsyet, që e kanë nxitur kandidatin/en për zgjedhjen e temës përkatëse. Në këtë pjesë kandidati shtjellon konceptet kyçe të hulumtimit, i cili propozohet përmes këtij projekti.

SHQYRTIMI I LITERATURËS

Në këtë pjesë kandidati bën një përshkrim të përgjithshëm të “fushës së studimit” dhe e përcakton temën e propozuar në kuadër të saj. Këtu është e domosdoshme të paraqiten, krahasohen dhe vlerësohen perspektivat teorike më të rëndësishme, që lidhen me temën e propozuar. Rekomandohet të bëhet një përshkrim i hollësishëm i hulumtimeve përkatëse (artikujve shkencorë, librave, raporteve hulumtuese) të realizuara prej autorëve të tjerë (vendorë dhe ndërkombëtarë) me përqendrim në gjetjet dhe përfundimet e tyre. Burimet që përdoren në shqyrtim të literaturës duhet të jenë të 15 viteve të fundit, me përjashtim kur ato janë teori apo filozofi të shtjelluara, apo edhe në rastet kur tema ngërthen trajtime të problematikave nga perspektiva historike/zhvillimore.

Shqyrtimi i literaturës nuk duhet të jetë një radhitje e materialeve të caktuara e as përmbledhje e civateve të zgjedhura, por duhet të jetë një përmbledhje e qëllimshme e asaj që thotë literatura ekzistuese për problemin që është duke u studiuar, duke përfshirë citime specifike dhe parafrazime të ideve të caktuara nga literatura. Po ashtu, duhet të bëhet e qartë arsyeshmëria dhe relevanca e kontributit teorik për hulumtimin e propozuar dhe mundësia e studimit të mëtejshëm të problematikës së zgjedhur. Në çdo rrethanë, secila ide që përdoret nga materialet tjera duhet të jepet burimi i autorësisë për t’iu shmangur praktikave të plagjiarizmit. Mund të bëhet citim i drejtpërdrejtë (nëse përdoret si citat) por edhe duke iu referuar autorit/materiailt nëse bëhet parafrazim.

Mund të ekzistojnë dy lloj dobësish në pikën e shqyrtimit të literaturës: referencat/bibliografia e zgjeruar ose e mangët. Në përgjithësi, për projekt-propozim kërkohet vetëm literatura kryesore, si ajo vendore ashtu edhe ndërkombëtare. Për hartimin e projekt-propozimeve mjaftojnë 10 deri 15 burime bibliografike, pasi duhet ta dimë se teza e masterit nuk do të jetë vetëm një përshkrim sistematik i një lëmi të caktuar dhe ekziston literaturë për temën e caktuar. Mund të referencohen vetëm ato burime të cilat janë përmendur në tekstin kryesor të projekt propozimit. Në procesin final të shkrimit të tezës së masterit numri i referencave bibliografike duhet të jetë më i lartë se në projekt-propozim. Edhe në projekt-propozim edhe tek teza e masterit, literatura duhet të jetë e dominuar nga burimet parësore, të viteve të fundit dhe e karakterit shkencor.

DEFINIMI I PROBLEMIT, FORMULIMI I QËLLIMIT, PYETJET E HULUMTIMIT DHE HIPOTEZA/T

Problemi i hulumtimit duhet të përkufizohet qartë, saktë dhe mirë. Qëllimet e hulumtimit duhet të jenë të harmonizuara me problemin e definuar. Parashtrimi i problemit dhe relevanca e tij duhet të jetë e lidhur me perspektivën teorike (d.m.th. shqyrtimin e literaturës), por edhe me pyetjen e hulumtimit dhe hipotezat si dhe metodat e planifikuara të hulumtimit. Një pikë e dobët në parashtrimin e propozimit të temës, qëndron në faktin se kandidatët nuk arrijnë të sigurojnë lidhje të mirë midis definimit të problemit dhe qëllimit me fazat e tjera, si p.sh., me perspektivën teorike, me pyetjen dhe hipotezat e parashtruara dhe të dhënat që mendohet të mblidhen për atë hulumtim.

Pyetjet e hulumtimit dhe hipotezat duhet të formulohen në atë mënyrë, që parimisht të jetë e mundur, që të jepet përgjigje ndaj pyetjes së ngritur. Preferohet të ketë një pyetje kryesore, por mund të ketë edhe nënpyetje të tjera ndihmëse për të precizuar fokusin e hulumtimit. Pyetja e hulumtimit duhet të jetë e qartë, e realizueshme, precize dhe sfiduese (inovative). Pyetja e hulumtimit e ngushton edhe më tej fokusin e hulumtimit të përcaktuar tek definimi i problemit dhe qëllimi i hulumtimit.

Studimet sasiore mund të kenë një hipotezë të hulumtimit (apo edhe më shumë, varësisht nga numri i pyetjeve të hulumtimit dhe qëllimi i definuar), që mund të verifikohet apo testohet (pra duhet të jenë fenomene të matshme) dhe hulumtuesi duhet të jetë në dijeni të testeve dhe analizave statistikore, të cilat mundësojnë matje të tilla. Hipoteza e hulumtimit duhet të jetë e formuluar saktë, në mënyrë që të shmanget dykuptimësia dhe kërkesat shtesë. Një hipotezë që nuk mund të verifikohet në ndonjë mënyrë të caktuar statistikore nuk është hipotezë. Në studimet cilësore, në parim nuk specifikohet hipoteza.

Studenti duhet të konsultojë literaturën shtesë të metodologjisë së hulumtimit, në bashkëpunim me mentorin, për të qartësuar specifikat dhe llojin e pyetjeve të hulumtimit, llojin e hipotezave dhe nevojën për metoda adekuate statistikore për mbështetjen apo refuzimin e hipotezave. Në projekt-propozim duhet të jepen argumentime dhe sqarime të nevojshme të mbështetura në literaturën e metodologjisë së hulumtimit jo më të vjetër se 15 vite.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Në këtë pjesë, studenti duhet të përshkruajë zgjedhjet metodologjike dhe t'i argumentojë ato sipas literaturës mbi metodologjinë e hulumtimit. Para së gjithash, studenti duhet të përcaktojë nëse hulumtimi i propozuar është i natyrës sasiore, cilësore apo i përzier. Më tej, duhet të përshkruhet edhe modeli apo strategjia e hulumtimit e zgjedhur për hulumtimin. Në këtë fazë duhet të sigurohet lidhja e qasjes së zgjedhur me natyrën e pyetjes së hulumtimit, për t'u siguruar se është bërë zgjedhja e përshtatshme metodologjike.

Pjesa e metodologjisë duhet të përfshijë po ashtu:

- Mostrën: lloji i mostrës që do të zbatohet, karakteristikat, parametrat kryesorë, dhe procedurat e përcaktimit të mostrës;
- Të dhënat: informacionet që do të mblidhen për të ofruar mundësinë e interpretimit të realitetit dhe dhënien e përgjigjes së kërkuar nga studimi;
- Instrumentet për mbledhjen e të dhënave: instrumentet që do të përdoren, si janë zhvilluar ato dhe variablat dhe konstruktet kryesore që reflektojnë instrumentet e zgjedhura;
- Procedurat dhe rrethanat e mbledhjes së të dhënave;
- Përpunimi dhe analiza statistikore deskriptive dhe inferenciale dhe analiza e të dhënave cilësore (varësisht nga studimi).

Në raste më të rralla, një problem i hulumtimit mund të studiohet përmes qasjes teorike. Lloji teorik i hulumtimit në tezën e masterit, mund të arsyetohet vetëm në rastet kur studiohen probleme të edukimit nga perspektiva historike. Argumentet në favor të hulumtimeve teorike duhet të paraqiten bindshëm, për ta bërë hulumtimin me këtë qasje si metodologji më të përshtatshme, duke theksuar kontributin e këtyre hulumtimeve në fushën e diturisë për fushën përkatëse. Në rast se studimi është teorik, duhet të bëhen modifikimet e duhura në procesin e realizimit dhe shkrimin të një hulumtimi teorik sipas literaturës adekuate për metodologji të hulumtimit.

INSTRUMENTET PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE

Në një projekt hulumtues duhet të planifikohen edhe instrumentet për mbledhjen e të dhënave, varësisht nga qasja e hulumtimit. Shkurtimisht përshkruhet se cilat variabla të studimit maten me instrumentet e propozuara dhe ato bashkëngjiten në shtojcën e projektit.

REZULTATET E PRITURA TË HULUMTIMIT

Projektpropozimi duhet të specifikojë rezultatet e pritura nga hulumtimi, duke u bazuar në kapitujt e mëparshëm të projektpropozimit. Po ashtu, rekomandohet që kandidati t'i parashtrojë ato që pret t'i kontribuojnë njohurive ekzistuese, teorisë dhe praktikës së lëmit të caktuar.

AFATI KOHOR I REALIZIMIT TË PUNIMIT

Duhet të hartohet një plan kohor i realizimit të secilit hap në procesin e hulumtimit. Afatet duhet të jenë sa më specifike, duke u adresuar të gjitha elementet dhe hapat e realizimit të hulumtimit dhe koha që do të duhet për realizimin e tyre. Nuk është e thënë të jepen data të caktuara, por, së paku numri i ditëve që duhen për të realizuar një hap të caktuar të hulumtimit. Paraqitja e planit kohor mund të paraqitet edhe në formë tabelore.

ÇËSH TJET ETIKE TË HULUMTIMIT

Në këtë pjesë studenti sqaron aspektet e ndryshme etike që lidhen me natyrën e hulumtimit dhe argumenton se cilat procedura do të ndiqen për t'iu ikur shkeljeve eventuale etike. Për shembull, nëse studenti ka planifikuar mostrën ku respondentët janë të mitur, studenti dëshmon se do të marrë lejen nga prindërit ose kujdestarët ligjor të fëmijëve, para se të administrojë instrumentet për mbledhjen e të dhënave.

INSTRUMENTET PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE

Parimi kryesor në shfrytëzimin e literaturës potencon se vetëm burimet bibliografike të përdorura (ato që janë cituar apo parafrazuar) duhet të vendosen në bibliografi.

Referencat dhe citimet duhet të bëhen sipas standardit të APA-s (American Psychological Association). Detajet e stilit APA janë dhënë në linkun: <http://www.apa.org/>, ndërsa këtu do të jepen vetëm disa sugjerime themelore. Stili i referencave APA kërkon nga autorët që të saktësojnë aty për aty burimin e idesë përkatëse e jo të tregojnë vetëm në fund literaturën e përdorur. P.sh. Jones (1998) ka argumentuar – thënë se..., ose një mënyrë tjetër që t'i referohemi një burimi të tillë, duke vendosur në kllapa mbiemrin e autorit dhe vitin e botimit, duke supozuar se referenca e plotë jepet në fund në listën e bibliografisë. Një ide mund të parafrazohet ose të vendoset në thonjëza nëse ideja kopjohet tërësisht nga burimi përkatës.

Një mënyrë tjetër për të saktësuar një burim të parafrazuar, bëhet duke vendosur në fund të idesë në kllapa autorin, vitin e botimit dhe numrin e faqes. Pra, në bibliografi përfshihen vetëm burimet që janë cituar diku në tekst dhe jo materialet që janë shfrytëzuar për lexim të përgjithshëm.

Udhëzime themelore orientuese: Më poshtë keni një shembull se si do të shkruhet në bibliografi referenca për libër (mbiemri dhe emri i autorit, viti i botimit, titulli i librit, vendi i botimit dhe botuesi):

Calfee, R. C., & Valencia, R. R. (2008). APA guide to preparing manuscripts for journal publication. Washington, DC: American Psychological Association

Më poshtë, keni një shembull se si do të shkruhet në bibliografi referenca për një artikull nga një revistë shkencore (mbiemri dhe emri i autorit, viti i botimit, titulli i artikullit, titulli i revistës, volumi, numri i faqeve):

Wegener, D. T., & Petty, R. E. (2004). Mood management across affective states: The hedonic contingency hypothesis. *Journal of Personality & Social Psychology*, 66, p. 1034-1048.

Mënyra për të shkruar referencën për një burim elektronik është si më poshtë: mbiemri i autorit, shkronja e parë e emrit, data/viti i botimit. Titulli i artikullit/materialit, volumi dhe numri nëse ekziston, data kur është marrë nga interneti, si edhe adresa nga është marrë. P.sh.:

Bernstein, M. (2006). 10 tips on writing the living web. *A List Apart: For People who Make websites*, 149. Marrë më 2 Maj, 2006, nga [Në një projekt hulumtues duhet të planifikohen edhe instrumentet për mbledhjen e të dhënave, varësisht nga qasja e hulumtimit. Shkurtime përshkruhet se cilat variabla të studimit maten me instrumentet e propozuara dhe ato bashkëngjiten në shtojcën e projektit.](#)

Për më shumë hollësi rreth citimit dhe përgatitjes së referencave/bibliografive mund të konsultoni "Publication Manual of the APA (American Psychological Association, 7th edition)" (2020).

Po ashtu, modele të tjera janë dhënë edhe në 'Modelin e shkrimit të tezës master'.

ETIKA HULUMTUESE DHE PLAGJIARIZMI

Plagjiatura është një formë e mashtrimit akademik. Të gjithë studentët duhet ta kenë të qartë kuptimin e nocionit plagjiaturë dhe të mënjanojnë plagjiaturën në punën e tyre gjatë studimeve. Plagjiaturë është kur një individ përdor idetë apo rezultatet hulumtuese të dikujt tjetër, sikurse ato të ishin të tij/saj. Kjo dukuri ndëshkohet rëndë në komunitetin akademik dhe për t'iu shmangur kësaj, studentët (dhe mësimmhënësit) duhet t'i referohen burimit të secilës ide që ata përdorin në punën e tyre. Sugjerohet që të gjithë studentët të përdorin softueret që janë të hapur apo në dispozicion për të kontrolluar plagjiarizmin (p.sh. turn it in), apo softueret që në ndërkohë vihen në dispozicion nga universiteti.

Një rëndësi e veçantë gjatë punës hulumtuese duhet t'i kushtohet procedurave etike. Hulumtimet kryhen në mjedise shoqërore dhe natyrore. Prandaj, është me rëndësi që studentët të marrin parasysh standardet e etikës profesionale dhe t'i respektojnë ato në klasë dhe në mjedisin ku kryhet hulumtimi. Në të kundërtën, do të paraqiten pengesa dhe vështirësi gjatë gjithë procesit të hulumtimit. Shpeshherë, mbledhja e të dhënave personale mund të jetë një çështje shumë e ndjeshme për individët apo grupet shoqërore. Po ashtu, kryerja e eksperimenteve të ndryshme apo respektimi i normave ligjore, shpeshherë shoqërohet me pengesa të ndryshme. Për këtë arsye është më se e domosdoshme që në çdo fazë të hulumtimeve të merren parasysh etika hulumtuese dhe integriteti akademik.

Parimet kryesore të etikës hulumtuese janë:

- Respektimi i dinjitetit njerëzor (trajtimi i personave në mënyrë të drejtë dhe respektimi i të drejtave të njeriut);
- Dobia (përpjekje për cilësi dhe përdorim më të mirë të burimeve, jo shfrytëzim i pjesëmarrësve të hulumtimit; hulumtimi bëhet për të bërë mirë dhe jo dëme).;
- Korrektesia (rëndësia e paanësisë, qasje e barabartë, respektimi i autorësisë, respektimi i individëve apo i grupeve të personave me nevoja të veçanta etj);
- Sinqeriteti (prezentimi i të gjeturave reale).

Gjatë punës hulumtuese, studentët duhet të respektojnë integritetin akademik dhe të përpiqen:

- të njohin kontributet e burimeve tjera në përpjekjet e tyre studimore;
- të përfundojnë punën e tyre hulumtuese në mënyrë të pavarur;
- të ndjekin udhëzimet për punën hulumtuese duke respektuar standardet e disiplinës akademike, dhe
- të shmangin angazhimet në cilëndo formë të pandershmerisë akademike.

Prandaj, para se të fillohet me punën hulumtuese, studentët duhet të marrin parasysh miratimin e deklaratave etike nga pjesëmarrësit e hulumtimeve të tyre. Departamenti do të analizojë të gjitha projekt-propozimet për të identifikuar problemet e plagjiarizmit në fazat e konceptimit të tezës master, ndërsa komisioni vlerësues dhe të gjitha palët e tjera, gjatë procesit të diskutimit publik dhe në secilën fazë tjetër, mund të ngritin dyshime të plagjiarizmit dhe Fakulteti i Edukimit do të ndërmarrë masa për të konfirmuar nëse punimi në fjalë ka probleme të tilla. Në rast se po, Këshilli i Fakultetit do të marrë masat adekuate sipas Rregullores së Studimeve Master dhe standardeve të tjera të zbatueshme në Universitetin e Prishtinës.



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

Shtojca 1: FM1

Fakulteti: _____

Departamenti _____

Programi: _____

KËRKESË

Departamentit të _____

Lënda: Kërkesë për vlerësimin e projekt propozimit të punimit të diplomës master

Në bazë të Rregullores për studime master, kërkoj nga departamenti të shqyrtoj propozimin tim për punimin e diplomës master, me titull

Për punimin master jam konsultuar me Prof. _____
/ Emri mbiemri dhe nënshkrimi/

Kërkesës ia bashkëngjes:

1. Projekt propozimin e punimit

Më: ____ Prishtinë

Emri dhe mbiemri i plotë

Tel: _____

E-mail: _____

Nënshkrimi i studentit



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

Shtojca 1: FM1

RAPORT VLERËSIMI TË PROJEKTPROPOZIMIT

FAKULTETI	
Departamenti/ Programi	
Projekt propozimi	
Kandidati	
Data dhe referenca e takimit të departamentit	

Vlerësimi i projekt propozimit dhe sugjerimet:

Rekomandimi final (Pranohet, pranohet me ndryshimet, refuzohet):

P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës. Vendi, data dhe nënshkrimet vijnë në fund sipas specifikat dhe praktikave në departamentin përkatë ose e nëshkruan shefi i departamentit.

1. _____ / Prof. 2. _____ / Prof.
3. _____ / Prof. 4. _____ / Prof.

SHTOJCAT

FAKULTETI
I EDUKIMIT



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

Shtojca 2: FM2

RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES MASTER

FAKULTETI	
Departamenti/ Programi	
Projektpropozimi	
Kandidati	
Mentori	
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë:
	Vendimi nr.:
Vlerësimi i dorëshkrimit	
<p>Prishtinë, _____</p> <p style="text-align: right;">Komisioni:</p> <p>1. _____ / Prof. – mentor/</p> <p>2. _____ / Prof. – anëtar/</p> <p>3. _____ / Prof. – anëtar/</p> <p>P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës. Vendi, data dhe nënshkrimet vijnë në fund.</p>	

Formulari i vlerësimit



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: _____

Datë: ___/___/___

Fakulteti: _____,

Departamenti _____,

Dosja nr. _____

V E N D I M

Punimi i diplomës me titull:

vlerësohet me notë _____.

Konstatohet se sipas dispozitave të rregullores për studime master janë plotësuar të gjitha kushtet që
kandidatit/es _____ t'i jepet titulli:

Komisioni / Emri mbiemri dhe nënshkrimi:

1. Prof. _____

2. Prof. _____

3. Prof. _____

Formulari i vlerësimit

UDHEZIME PËR PROCESIN E MBROJTJES SE PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

Kryetari i Komisionit:

Prof. _____

Prishtinë, _____, Salla _____, Koha _____

ZONJA DHE ZOTËRINJ!

Në bazë të Rregullores të studimeve master, më lejoni të hapi seancën për mbrojtjen publike të punimit master të kandidatit/es _____, me titull

“ _____ ”

Procedura në tërësi e kësaj mbrojtjeje ka rrjedhur si në vijim:

1. ¹Vendimi mbi formimin e komisionit për vlerësimin e projekt propozimit të punimit të masterit në përbërje:

1. Prof. _____

2. Prof. _____

3. Prof. _____

dhe caktimi i mentorit të temës, Prof. _____, sipas vendimit nr. _____, datë __/__/____, të mbledhjes së Këshillit të Fakultetit të mbajtur më datën __/__/____.

- Në vazhdim, kryetari paraqet jetëshkrimin e kandidatit/es, ndërsa mentorin paraqet në pika të shkurtra përmbajtjen dhe arsyeshmërinë e temës master.
- Kryetari i jep fjalën kandidatit/es, për mbrojtje të punimit të diplomës master në kohëzgjatje deri 30 min.
- Pas përfundimit të prezantimit, kryetari pyet kandidatin/en se a mund të vazhdohet me pyetje ose ka nevojë për një pauzë të shkurtër.
- Pas miratimit nga ana e kandidatit për vazhdim përkatësisht pas pauzës së shkurtër kryetari jep mundësinë për pyetje dhe diskutim.
- Së pari pyetje parashtrajnë anëtarët e komisionit dhe më pas edhe audiencia. Në rast nevojë mund të ndihmoj ose të përgjigjet në pyetje edhe mentorin i punimit të diplomës.
- Pas pyetje përgjigjeve dhe diskutimit, komisioni tërhiqet për këshillim dhe votim.
- Pas konsultimeve të komisionit për mbrojtje, kryetari shpall rezultatin e vlerësimit (të pranishmit në sallë ngritën në këmbë)
- Plotësohet Vendimi dhe nënshkruhet dhe pastaj vendoset nota në SEMS. Vendimi (dhe kopja e notës në SEMS sipas praktikave në njësi akademike) dorëzohen në shërbimin master.

¹ Specifikohet nëse ka pasur ndryshim të komisionit në hapat e tjerë gjatë procesit dhe informacione relevante gjatë diskutimit publik dhe finalizimit të hapave.



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I EDUKIMIT**

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

Shtojca 4. Deklaratë etike

Deklaratë etike

Me këtë deklaratë, unë _____ zotohem me vetëdije të plotë se për dorëshkrimin _____ janë plotësuar kushtet si më poshtë:

- 1) Janë siguruar të gjitha praktikat më të mira etike gjatë kryerjes së hulumtimit
- 2) Është respektuar dinjiteti dhe konfidencialiteti i gjithë pjesëmarrësve në hulumtim
- 3) Materiali është vepër origjinale e vetë autorit, që pasqyron kërkimin dhe analizën e vetë autorit në një mënyrë të vërtetë dhe të plotë.
- 4) Rezultatet janë reale dhe të besueshme
- 5) Të gjitha burimet e përdorura janë shpalosur siç duhet (citim i saktë).

Data:

Nënshkrimi i autorit:

FAKULTETI I EDUKIMIT

ZYRA E SHËRBIMIT MASTER

YLLKA ALIDEMA yllka.alidema@uni-pr.edu

ALBAN HOXHA alban.hoxha@uni-pr.edu

GRESA RETKOCERI gresa.retkoceri@uni-pr.edu

master.edukimi@uni-pr.edu

www.edukimi.uni-pr.edu

+383 38 229 201
